

Fondi i Zgjerimit të Sipërmarrjeve II

Vendi: Rajonal

Numër Projekti: 52255

Sektori i Biznesit: Fonde Kapitali

Lloji i Njoftimit: PRIVAT

Kategoria Mjedisore: Platformë e pa kategorizuar

Data e Synuar për Aprovim: 10 Nëntor 2021

Statusi: Vlerësim i konceptit

Publikimi i dokumentit përmbledhës të projektit:

Përshkrimi i Projektit

Një investim në kapital deri në 20 milionë euro dhe një linjë bashkë-investimi në kuadër të Fondit të Zgjerimit të Sipërmarrjeve II në Ballkanin Perëndimor ("ENEF II ose "Fondi"), pjesë e Platformës për Impakt dhe Zgjerim të Sipërmarrjeve SA SICAV RAIF (Platforma), një fond i rezervuar alternativ investimi (RAIF) që do të regjistrohet në Luksemburg dhe do të mbështetet nga Programi për Zhvillimin e Sipërmarrjeve dhe Inovacion në Ballkanin Perëndimor (EDIF në Ballkanin Perëndimor ose EDIF). ENEF II do të ofrojë investime me kapital, kuazi-kapital dhe financime të përshtatura me borxh për SME-të vendase në rritje dhe kompanitë me kapital mesatar në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbi. BERZH do të shërbejë si këshilltar investimi për Fondin.

ENEF II do të vazhdojë aktivitetet e Fondit të Zgjerimit të Sipërmarrjeve që u prezantua nën EDIF në Ballkanin Perëndimor në 2014 dhe arriti të investojë në 16 kompani deri në përfundimin e tij në Korrik 2020.

Objektivat e Projektit

Të mbushës boshllëqet në treg me kapital, kuazi-kapital dhe financime të përshtatura me borxh për SME-të vendase dhe kompanitë me kapital të mesëm në Ballkanin Perëndimor, dhe të ofrojë mbështetje përpara dhe pas financimit për kompanitë e mbështetura nga Fondi, përfshirë identifikimin dhe adresimin e mundësive dhe risqeve Mjedisore, Sociale dhe të mirë Qeverisjes ("ESG").

Impakti në Tranzicion

ETI 67

Fondi do të kontribuojë në cilësinë e "Qëndrueshmërisë" duke rritur qasjen ndaj burimeve alternative të financimit si kapitali dhe kuazi-kapitali, dhe cilësinë e "Konkurueshmërisë" duke mbështetur kompanitë e mbështetura në përballimin e risqeve Mjedisore, Sociale dhe të mirë Qeverisjes si dhe në identifikimin e mundësive dhe përmes formave të tjera të asistencës pas investimit.

Sipas kushteve të bashkë-investimit midis Fondit dhe BERZH, impakti në tranzicion i projekteve individuale do të vlerësohet rast pas rasti dhe cilësi të tjera tranzicioni mund të identifikohen.

Informacion për Klientin

FONDI I ZGJERIMIT TË SIPËRMARRJEVE II

Fondi i Zgjerimit të Sipërmarrjeve II në Ballkanin Perëndimor do të krijohet si një nën-ndarje e Platformës për Impakt dhe Zgjerim të Sipërmarrjeve SA SICAV RAIF, një fond i rezervuar alternativ investimi që do të regjistrohet në Luksemburg si një korporatë (shoqëri anonime) dhe do të administrohet nga IQEQ, Menaxhues Fondi për Investime Alternative, i rregulluar nga Komisioni i Mbikqyrjes së Seksionit Financiar. Madhësia minimale e fondit do të jetë 40 milionë euro dhe ajo maksimale 75 milionë euro. Mbyllja e parë pritet të jetë në 3 mujorin e katërt të 2021.

Përmbledhja e Financimit të BERZH

EUR 20,000,000.00

BERZH do të angazhojë aksione të klasit A në Fond (shiko mëposhtë).

Kostoja Totale e Projektit

EUR 74,500,000.00

ENEF II do të mbledhë deri në 75 milionë euro kapital nga BERZH, KE (përmes Fondit European të Investimeve, EIF) dhe nga Institucione të tjera të Zhvillimit Financiar dhe investitorë. Fondi do të ketë dy klasa aksionesh: një senior (të klasit A) deri në 47.5 milionë euro dhe një të varuar (të klasit B) deri në 27.5 milionë euro. Aksionet e klasit B do të garantojnë mbulimin e humbjeve të para për aksionet e klasit A, dhe do të regjistrohen nga Fondi European i Investimeve (për llogari të KE) dhe KfW.

Përmbledhja Mjedisore dhe Sociale

Platforma në vetvete është kuadër dhe si e tillë nuk është e kategorizuar. Nën-projektet do të kategorizohen dhe vlerësohen rast pas rasti. Studime të pavarura mjedisore dhe sociale do të ndërmerren kur është e nevojshme me asistencë nga konsulentë të jashtëm për të kuptuar të gjithë përgjegjësitë dhe risqet mjedisore dhe sociale që lidhen me veprimtaritë e kompanisë si dhe për zhvillimin dhe dakordësimin e një plani masash mjedisore dhe sociale kur nevojitet. Proçesi i vlerësimit do të përdoret gjithashtu për të identifikuar mundësitë për përmirësime mjedisore dhe sociale dhe përcaktimin e një sistemi metrik për të matur zbatueshmërinë e masave të dakordësuara. Kompanitë do të duhet të veprojnë në përputhje me Kriteret e Përformancës të Bankës, përfshirë standartet mjedisore vendase dhe të BE për mjedisin, shëndetin, sigurinë dhe menaxhimin në punë, dhe të përgatisin një raport vjetor për çështjet mjedisore, sociale dhe të shëndetit.

Bashkëpunimi Teknik

ENEF II do të mund të përfitojë deri në 9 milionë euro fonde për bashkëpunim teknik të ofruara nga KE (7 milionë euro) dhe Italia (2 milionë euro) me qëllim: a) Mbështetjen përpara investimit, përfshirë ekzaminimin sistematik të profilit Mjedisor, Social dhe të Mirëqeverisjes së kompanisë së investuar dhe mundësive të tjera për përmirësim; b) mbështetje pas investimit, përfshirë zbatimin e planeve të masave që përfshijnë çështje të rëndësishme Mjedisore, Sociale dhe të Qeverisjes; c) zhvillim të biznesit dhe stafit; dhe d) Mbulimin e kostove fillestare.

Vlera e Shtuar

Pjesëmarrja e Bankës si investitor, bashkë-investitor dhe këshilltar investimi është e domosdoshme për suksesin e Fondit. Kjo vjen si pasojë e mungesës së menaxherëve të fondeve në të gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor si dhe interesit të kufizuar të institucioneve financiare për t'u përfshirë në to. Eksperienca e gjerë dhe prezenca në vend e BERZH do të mundësojnë tërheqjen e investitorëve të tjerë dhe krijimin e një fondi të strukturuar që do të mbulojë boshllëqet e tregut dhe do të përqëndrohet në realizimin e një impakti Mjedisor, Social dhe të Qeverisjes.

Informacion për kontaktin e kompanisë

Nikolay Angelov

angelovn@ebrd.com

+442040704429

EBRD, One Exchange Square, EC2A 2JN, London, the United Kingdom

Ndikimi në Tranzicion

Për informacion të mëtejshëm lidhur me qasjen e BERZH ndaj matjes së ndikimit në tranzicion mund të lexoni [këtu](#).

Mundësitë e biznesit

Për mundësitë për biznes ose prokurim, kontaktoni shoqërinë kliente.

Për mundësi biznesi me BERZH (që nuk lidhen me prokurimin) kontaktoni:

Tel: +44 20 7338 7168

Email: projectenquiries@ebrd.com

Për projektet në sektorin shtetëror, vizitoni [Prokurimet e BERZH](#):

Tel: +44 20 7338 6794

Email: procurement@ebrd.com

Pyetje të përgjithshme

Mund të bëni pyetje specifike duke përdorur [Formularin e pyetjeve të BERZH-it](#).

Politika Mjedisore dhe Sociale (PMS)

[PMS](#) dhe Kriteret e Performancës (PR) përcaktojnë mënyrën se si BERZH zbaton angazhimin e saj për promovimin e “zhvillimit të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm mjedisor”. PMS dhe PR përfshijnë dispozita specifike në mënyrë që klientët të veprojnë në përputhje me kërkesat e zbatueshme të legjisllacionit kombëtar për informacionin dhe këshillimin publik, si dhe të ngrënë mekanizmat e ankimimit për të adresuar dhe lehtësuar zgjidhjen e shqetësimeve dhe ankesave të palëve të interesit, veçanërisht sa i përket përgjegjësisë mjedisore dhe sociale të klientit dhe projektit. Në

raport të drejtë me natyrën dhe shkallën e riskut dhe ndikimit mjedisor dhe social të projektit, BERZH i kërkon klientëve të publikojnë gjithashtu informacion, sipas rastit, mbi risqet dhe ndikimet e projektit ose të kryejnë këshillime gjithëpërfshirëse me palët e interesit dhe të marrin në konsideratë e t'i përgjigjen reagimit të tyre.

Më shumë informacion mbi praktikën e BERZH në këtë aspekt jepet në [PMS](#).

Integriteti dhe Përputhshmëria

Zyra e Krye Oficerit të Përputhshmërisë (OCCO) së BERZH promovon qeverisjen e mirë dhe siguron zbatimin e standardeve më të larta të integritetit në të gjitha veprimtaritë e Bankës, në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare. Të gjithë klientëve e Bankës duhet t'u nënshtrohen kontrolleve të integritetit për t'u siguruar që projektet nuk paraqesin rrisqe të papranueshme integriteti apo reputacioni për Bankën. Banka beson se identifikimi dhe zgjidhja e problematikave gjatë fazave të vlerësimit për miratimin e projektit, është mënyra më efikase për të siguruar integritetin e transaksioneve të Bankës. OCCO luan rol kyç në këto përpjekje mbrojtëse dhe gjithashtu ndihmon me monitorimin e rreziqeve ndaj integritetit në fazën e pas investimit në projekt.

OCCO është gjithashtu përgjegjëse për verifikimin e akuzave për mashtrim, korrupsion dhe shkelje në projektet e financuara nga BERZH Kushdo, qoftë pjesë apo jo e Bankës, që ka dyshime prr praktika mashtrimi apo korruptive duhet të paraqesë një raportim me shkrim në adresë të Krye Oficerit të Përputhshmërisë përmes postës elektronike tek compliance@ebrd.com. Të gjitha çështjet e raportuara do të ndiqen nga OCCO. Të gjitha raportimet, përfshirë ato anonime, do të shqyrtohen. Raportimet mund të bëhen në çfarëdolloj gjuhe të Bankës apo të vendeve ku Banka vepron. Informacioni i dhënë duhet të jepet në mirëbesim.

Politika e Qasjes në Informacion (PQI)

PQI përcakton mënyrën se si BERZH e shpalos informacionin dhe këshillohet me grupet e interesit për të nxitur ndërgjegjësimin dhe të kuptuarit më të mirë të strategjive, politikave dhe operacioneve të veta pas hyrjes në fuqi të saj më 1 janar 2020. Ju lutemi vizitoni faqen e [Politikës së Qasjes në Informacion](#) për t'u informuar mbi informacionin e disponueshëm në faqen e BERZH.

Kërkesat për informacion të veçantë mund të bëhen duke përdorur [Formularin e pyetjeve të BERZH](#).

Mekanizmi i Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit (MPPP)

Nëse përpjekjet për të trajtuar shqetësimet mjedisore, sociale, apo të bërjes publike me Klientin apo Bankën nuk kanë rezultat (p.sh., përmes mekanizmit të ankimit në nivel projekti të Klientit, ose përmes kontaktit të drejtpërdrejtë me ekipin drejtues të Bankës) individët dhe organizatat mund t'i trajtojnë shqetësimet e tyre përmes Mekanizmit të Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit (MPPP) të BERZH.

MPPP shqyrton në mënyrë të pavarur problematikat e Projektit që mendohet se kanë (ose mund të shkaktojnë) dëme. Qëllimi i mekanizmit është të: mbështesë dialogun midis palëve të interesit të

Projektit për të zgjidhur problematikat mjedisore, sociale dhe të publikimit të informacionit; të përcaktojë nëse Banka vepron në përputhje me [Politikën Mjedisore dhe Sociale](#) apo dispozitat specifike për Projektin të [Politikës së Qasjes në Informacion](#); dhe nëse gjen zbatim të trajtojë çdo devijim nga këto politika, duke parandaluar kështu edhe cdo devijim apo mospërputhje nga ana e Bankës në të ardhmen.

Ju lutem vizitoni faqen e webit për [Mekanizmin e Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit](#) për të mësuar më shumë mbi MPPP dhe misionin e tij; si dhe për të [dërguar një kërkesë](#) për rishikim; ose për të kontaktuar MPPP përmes emailit ipam@ebrd.com për më shumë informacion dhe udhëzime mbi mekanizmin dhe dërgimin e kërkesave.